



AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E MONUMENTEVE DHE KOMPLEKSEVE MEMORIALE  
AGENCY ON MANAGEMENT OF MEMORIAL OF THE COMPLEXES OF KOSOVO

Komuna e Malishevës  
Municipality of Malisheva

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture,  
Omladine i Sporta /Ministry of Culture, Youth & Sports  
Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale  
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova  
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

Komuna e Malishevës  
Opštine Malishevo  
Municipality of Malisheva

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive të Pavarura, nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligjit nr. 08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhtin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, palët nënshkruese janë pajtuar për të nënshkruar këtë:

**MARRËVESHJE TË MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM**

**PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT  
Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit "Adem Jashari"  
NË KOMUNËN E MALISHEVËS**

Palët Nënshkruese:  
Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale e përfaqësuar nga  
z. Imer Hakaj, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë  
dhe

Komuna e Malishevës e përfaqësuar nga z. Ekrem Kastrati, Kryetar i Komunës së Malishevës

**Neni 1  
Qëllimi**

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit nënshkruhet në mes të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe Komunës së Malishevës, me qëllim të përcaktimit të obligimeve dhe përgjegjësisë të financimit të projektit të përbashkët me titull: Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit "Adem Jashari" në Malishevë i cili do të implementohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës".

**Neni 2  
Mënyra e bashkëfinancimit të projektit**

1. Projekti "Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit "Adem Jashari" në Malishevë, sipas planifikimit buxhetor ka koston financiare në total prej 8,277,887 .67€ (tetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e shtatë cent).

I.H

E.K

2. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale financon këtë projekt në vlerën prej 100,000.00€ (njëqind mijë euro) për vitin 2023, nga projekti me kod 15395 i paraparë në buxhetin e Agjencisë për vitin 2023.

3. Komuna e Malishevës financon këtë projekt në vlerën prej 8,177,887 .67€ (tetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e shtatë cent), nga kodi i projektit 51787, i paraparë në buxhetin e Komunës së Malishevës, për vitin 2023.

### **Neni 3**

#### **Obligimet e Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale**

1. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, në pajtim me ligjin dhe këtë marrëveshje, zoton mjetet për projektin e paraparë në nenin 2 të kësaj marrëveshje dhe një kopje të zotimit e dërgon në Komunën e Malishevës për realizimin e projektit.

2. Pagesa për financimin e projektit Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit "Adem Jashari" në Malishevë, nga Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale do të ekzekutohet në pajtim me realizimin e projektit, sipas situacionit dhe raportit të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës dhe Menaxherit të projektit të përcaktuar nga Komuna e Malishevës .

3. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale mund të caktoj një zyrtar vëzhgues për përcjelljen e zbatimit të projektit.

### **Neni 4**

#### **Obligimet e Komunës**

1. Komuna e Malishevës obligohet që projektin Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit "Adem Jashari" në Malishevë ta realizoj në kuadër të projektit "Ndërtimi i Sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës".

2. Komuna e Malishevës, njofton Agjencinë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për emërimin e Menaxherit të Kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, për realizimin e projektit si dhe për inspektimin e punimeve deri në përfundimin e projektit.

3. Komuna e Malishevës është e obliguar që të njoftoj Agjencinë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për të gjithë hapat e realizimit të projektit për pjesën për të cilën kryen financimin Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Marrëveshja e lidhur ndërmjet Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe Komunës së Malishevës përfundon me realizimin e projektit respektivisht me

/#



ekzekutimin e pagesës nga ana e Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për vlerën e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 2 të kësaj marrëveshje.

#### Neni 6

#### Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes

1. Palët nënshkruese, zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje bashkëfinancimi dhe në rast të kontestit eventual apo paqartësie për zbatimin e kësaj marrëveshje, pajtohen që përmes bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim të gjendet zgjidhje përkatëse, e në të kundërtën pajtohen që për zgjidhjen e kontestit t'i drejtohen gjykatës kompetente.
2. Për plotësimin dhe ndryshimin eventual të kësaj marrëveshje, palët nënshkruese pajtohen që të ndjekin rrugën e njëjtë si për nënshkrimin e marrëveshjes bazë.

#### Neni 7

#### Pronësia e projektit

1. Me pranim-dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky projekt i paraparë sipas kësaj marrëveshje të mirëkuptimit, do të regjistrohet në pronësi të Komunës së Malishevës.
2. Ky projekt regjistrohet në pronësi të Komunës së Malishevës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

#### Neni 8

#### Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje mirëkuptimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë identik dhe secila palë nënshkruese merr nga dy ekzemplarë.
2. Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit fillon të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj.

**SQARIM:** Projekti i planifikuar të realizohet nga ana Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, sipas Planit të Prokurimit të AMMKM-së është përcaktuar të fillojë procedurën e prokurimit në muajin mars të vitit 2023, mirëpo pasi është kuptuar se në hapësirën e njëjtë ku është paraparë të kryhet investimi nga ana e AMMKM-së, Komuna e Malishevës tashmë ka filluar realizimin e projektit të nënshkruar me 12.01.2023 që ka të bëjë pikërisht me rregullimin e këtij sheshi siç dhe AMMKM ka planifikuar projektin, bëhet kjo marrëveshje e bashkëfinancimit.

#### PALET NËNSHKRUERE TË MARRËVESHJES

IMER HAKAJ

Drejtor Ekzekutiv  
Agjencia për Menaxhimin  
e Monumenteve dhe  
Komplekseve Memoriale



EKREM KASTRATI

Kryetar i Komunës  
Komuna e Malishevës



Datë: 01.12.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit/Ministarstvo Kulture,  
Omladine i Sporta /Ministry of Culture, Youth & Sports  
Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale  
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova  
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

Komuna e Malishevës  
Opština Mališevo  
Municipality of Malisheva

Në mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive të Pavarura, nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 5 të Ligjit nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligjit nr. 08/L-193 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, palët nënshkruese janë pajtuar për të nënshkruar këtë:

### MARRËVESHJE TË MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM

#### PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit "Adem Jashari" NË KOMUNËN E MALISHEVËS

Palët Nënshkruese:

Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale e përfaqësuar nga  
z. Imer Hakaj, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë  
dhe

Komuna e Malishevës e përfaqësuar nga z. Ekrem Kastrati, Kryetar i Komunës së Malishevës

#### Neni 1 Qëllimi

Kjo marrëveshje e mirëkuptimit nënshkruhet në mes të Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe Komunës së Malishevës, me qëllim të përcaktimit të obligimeve dhe përgjegjësi të financimit të projektit të përbashkët me titull: Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit "Adem Jashari" në Malishevë i cili do të implementohet në kuadër të projektit "Ndërtimi i Sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës".

#### Neni 2

#### Mënyra e bashkëfinancimit të projektit

1. Projekti "Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit "Adem Jashari" në Malishevë, sipas planifikimit buxhetor ka koston financiare në total prej 8,277,887 .67€ (tetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e shtatë cent).

*[Handwritten signature]*

*[Handwritten signature]*



2. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale financon këtë projekt në vlerën prej 100,000.00€ (njëqind mijë euro) për vitin 2023, nga projekti me kod 15395 i paraparë në buxhetin e Agjencisë për vitin 2023.

3. Komuna e Malishevës financon këtë projekt në vlerën prej 8,177,887 .67€ (tetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e shtatë cent), nga kodi i projektit 51787, i paraparë në buxhetin e Komunës së Malishevës, për vitin 2023.

### **Neni 3**

#### **Obligimet e Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale**

1. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, në pajtim me ligjin dhe këtë marrëveshje, zoton mjetet për projektin e paraparë në nenin 2 të kësaj marrëveshje dhe një kopje të zotimit e dërgon në Komunën e Malishevës për realizimin e projektit.
2. Pagesa për financimin e projektit Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit "Adem Jashari" në Malishevë, nga Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale do të ekzekutohet në pajtim me realizimin e projektit, sipas situacionit dhe raportit të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës dhe Menaxherit të projektit të përcaktuar nga Komuna e Malishevës .
3. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale mund të caktoj një zyrtar vëzhgues për përcjelljen e zbatimit të projektit.

### **Neni 4**

#### **Obligimet e Komunës**

1. Komuna e Malishevës obligohet që projektin Rregullimi dhe mirëmbajtja e sheshit "Adem Jashari" në Malishevë ta realizoj në kuadër të projektit "Ndërtimi i Sheshit së bashku me nënkalimet dhe parkingun nëntokësor në qytetin e Malishevës".
2. Komuna e Malishevës, njofton Agjencinë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për emërimin e Menaxherit të Kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, për realizimin e projektit si dhe për inspektimin e punimeve deri në përfundimin e projektit.
3. Komuna e Malishevës është e obliguar që të njoftoj Agjencinë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për të gjithë hapat e realizimit të projektit për pjesën për të cilën kryen financimin Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale.

### **Neni 5**

#### **Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Marrëveshja e lidhur ndërmjet Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe Komunës së Malishevës përfundon me realizimin e projektit respektivisht me

1/H

E.K

ekzekutimin e pagesës nga ana e Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale për vlerën e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 2 të kësaj marrëveshje.

#### Neni 6

#### Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes

1. Palët nënshkruese, zotohen se do t'i përmbahen kësaj marrëveshje bashkëfinancimi dhe në rast të kontestit eventual apo paqartësie për zbatimin e kësaj marrëveshje, pajtohen që përmes bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim të gjendet zgjidhje përkatëse, e në të kundërtën pajtohen që për zgjidhjen e kontestit t'i drejtohen gjykatës kompetente.
2. Për plotësimin dhe ndryshimin eventual të kësaj marrëveshje, palët nënshkruese pajtohen që të ndjekin rrugën e njëjtë si për nënshkrimin e marrëveshjes bazë.

#### Neni 7

#### Pronësia e projektit

1. Me pranim-dorëzimin e punëve të kryera nga ana e operatorit ekonomik, ky projekt i paraparë sipas kësaj marrëveshje të mirëkuptimit, do të regjistrohet në pronësi të Komunës së Malishevës.
2. Ky projekt regjistrohet në pronësi të Komunës së Malishevës në mënyrë elektronike dhe fizike, në sistemin e pasurisë në Ministrinë e Financave (SMIFK).

#### Neni 8

#### Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje mirëkuptimi është hartuar në 4 (katër) ekzemplarë identik dhe secila palë nënshkruese merr nga dy ekzemplarë.
2. Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit fillon të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj.

**SQARIM:** Projekti i planifikuar të realizohet nga ana Agjencisë për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, sipas Planit të Prokurimit të AMMKM-së është përcaktuar të fillojë procedurën e prokurimit në muajin mars të vitit 2023, mirëpo pasi është kuptuar se në hapësirën e njëjtë ku është paraparë të kryhet investimi nga ana e AMMKM-së, Komuna e Malishevës tashmë ka filluar realizimin e projektit të nënshkruar me 12.01.2023 që ka të bëjë pikërisht me rregullimin e këtij sheshi siç dhe AMMKM ka planifikuar projektin, bëhet kjo marrëveshje e bashkëfinancimit.

**PALET NËNSHKRUERE TË MARRËVESHJES**

**IMER HAKAJ**  
  
Drejtor Ekzekutiv  
Agjencia për Menaxhimin  
e Monumenteve dhe  
Komplekseve Memoriale



**EKREM KASTRATI**  
  
Kryetar i Komunës  
Komuna e Malishevës



Datë: 01.12.2023